

FËMIJA IM ËSHTË NË SHKOLLË

SI FUNKSIONON SHKOLLA NË
LANDIN BADEN-WÜRTTEMBERG?
ÇFARË PRET SHKOLLA NGA UNË
SI NËNË/BABA DHE NGA FËMIJA IM?
SI MUND TA MBËSHTES FËMIJËN
TIM NË EDUKIMIN SHKOLLOR?



PËRMBAJTJE

SI FUNKSIONON SHKOLLA NË LANDIN BADEN-WÜRTTEMBERG? _____

3

Sistemi shkollor në Baden-Württemberg _____ 4

Detyrimi shkollor _____ 6

ÇFARË PRET SHKOLLA NGA UNË SI NËNË/BABA DHE NGA FËMIJA IM? _____

7

Çfarë pritet nga fëmijët _____ 8

Çfarë pritet nga prindërit _____ 8

Mbrëmje me prindërit _____ 9

Festat fetare _____ 9

Sëmundja _____ 10

SI MUND TA MBËSHTES FËMIJËN TIM NË EDUKIMIN SHKOLLOR? _____

11

Mbështetja e fëmijës _____ 12

Prindërit ... _____ 12

Materialet mësimore _____ 12


Ushqimi i pushimit me vete _____ 13

Ndihma në kryerjen e detyrave të shtëpisë _____ 14


Konsultime të mëtejme _____ 15

SI FUNKSIONON SHKOLLA NË LANDIN BADEN- WÜRTTEMBERG?





SISTEMI SHKOLLOR NË BADEN-WÜRTTEMBERG



DETYRIMI SHKOLLOR

Është përgjegjësia e prindërve, që fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë.

- > Fëmija duhet të jetë në çdo ditë mësimi me përpikëri në shkollë.
- > Ai duhet të marrë pjesë në çdo aktivitet të detyruar shkollor, p. sh. në ekskursione, në shëtitje, në teatër, në mësimin e notit.
- > Në rastin kur fëmija sëmuret: Shkolla duhet të njoftohet në të njëjtën ditë. Jo më vonë se pas 3 ditësh shkollës i nevojitet justifikimi/raporti me shkrim.

Pushimet shkollore nuk lejohet të nisin më parë apo të shtyhen më gjatë. Për festat e mëdha fetare (p. sh. festa e Ramazanit apo Kurban Bajramit) prindërit mund të bëjnë kërkesë për leje pushimi të veçantë.



ÇFARË PRET SHKOLLA NGA UNË SI NËNË/ BABA DHE NGA FËMIJA IM?



ÇFARË PRITET NGA FËMIJËT

Nga fëmijët pritet, që ata...

- > të marrin pjesë në mësim dhe të aktivizohen
- > të mos bezdisin
- > të respektojnë mësuesen/mësuesin
- > të drejtojnë pyetje
- > të kryejnë detyrat e shtëpisë

Përdorimi i telefonit celular në shkollë është i ndaluar.

ÇFARË PRITET NGA PRINDËRIT

Prindërit dhe shkolla bashkëpunojnë për suksesin shkollor të fëmijës. Shkolla dëshiron kontakt të rregullt me prindërit. Prindërit ...

- > janë partnerë kontaktimi të barabartë për shkollën
- > kryejnë biseda prindër - mësues
- > vizitojnë mbrëmjet me prindërit



MBRËMJE ME PRINDËRIT

Mbrëmja me prindërit mbahet 2 herë gjatë vitit shkollor, përkatësisht në mbrëmje. Njoftimi për këtë kryhet nga mësuesja/mësuesi ose nga përfaqësuesit e prindërve. Pritet të merrni pjesë. Këtu informohet mbi takime të rëndësishme, shpërndahen dokumente, mblidhen para për arkën e klasës dhe do t'ju përgjigjet pyetjeve. Përveç kësaj, do të zgjidhen edhe përfaqësuesit e prindërve (zakonisht 2 persona).

Për problemet në komunikimin gjuhësor, shkolla mund të kërkoj për prindërit, përkthyes vullnetarë, pa pagesë. Ju lutemi të informoni mësuesen/mësuesin, nëse dëshironi një të tillë.

FESTAT FETARE

- > Një pjesë e madhe e fëmijëve të lindur në qarkun e Landkreis Heilbronn janë ose katolikë ose protestantë.
- > Është e vërtetë, që shumë prej prindërve i përkasin besimit të fesë katolike, por në fakt nuk janë më aktivë në kishë.
- > Në shkollë festohen ose shënohen kryesisht festat dhe traditat katolike si Nikolaus, Pashkët, Krishtlindjet
- > Zakonisht të gjithë fëmijët festojnë së bashku
- > Shumë festa fetare kanë përfutur një karakter botëror (Pashkët me lepurushin e pashkëve, Krishtlindjet me Nikolausin).



Për festat e mëdha të feve të tjera, prindërit mund të kërkojnë në shkollë leje të veçantë pushimesh.

SËMUNDJA

Nëse fëmija juaj është i sëmurë dhe nuk mundet të vij në shkollë, atëherë ju duhet të njoftoni gojarisht/me telefon përpara se të nis mësimi. Deri në ditën e tretë të sëmundjes, fëmijës tuaj i nevojitet një justifikim shtesë me shkrim (shih shembullin).

Nëse fëmija juaj nuk mundet të marrë pjesë në orën e sportit, i nevojitet gjithashtu një justifikim/raport.

Datum: _____

ENTSCULDIGUNG

Wegen Krankheit konnte mein Kind

Klasse _____ vom _____ bis _____ (Datum)

die Schule nicht besuchen.

Ich bitte, ihr/sein Fernbleiben zu entschuldigen.

(Unterschrift)



WIE KANN ICH MEIN KIND IN DER SCHULE UNTERSTÜTZEN?



MBËSHTETJA E FËMIJËS

PRINDËRIT ...

- > sigurojnë materialin e nevojshëm shkollor
- > i japin fëmijës bukë/ushqim me vete për pushimin (Vesper)
- > kujdesen që të kryhen detyrat e shtëpisë
- > kontrollojnë çantën e shkollës
- > kujdesen, që fëmija të sillet mirë në shkollë, nxisin aftësitë e domosdoshme të fëmijës

MATERIALET MËSIMORE

Zakonisht në fillim të vitit shkollor mësuesja/mësuesi shpërndan një listë materialesh. Për shkollën është e rëndësishë së veçantë, që të jetë materiali i kërkuar.

Në dyqan ju mund të merrni ndihmën e duhur për mbledhjen e materialeve të duhura. Materiali që mungon duhet të riblihet rregullisht (p. sh. fletoret).



USHQIMI I PUSHIMIT ME VETE

Orari mësimor i fëmijëve parashikon një pushim për mëngjesin. Jepini fëmijës tuaj çdo ditë ushqim të shëndetshëm me vete.

I tillë është p. sh.:

- > Buka e lyer/shoqëruar me gjëra të ndryshme
- > Frutat: mollë, rrush, mandarina, banane, dardhë etj.
- > Perime të prera: domate, kastravec, spec, feta karrote etj.
- > Për të pirë: shishe uji



NDIHMJA NË KRYERJEN E DETYRAVE TË SHTËPISË

Prindërit sigurojnë, që detyrat e shtëpisë të jenë kryer. Fëmija ka nevojë për një vend të qetë pune për kryerjen e detyrave të shtëpisë. Kontrolloni çdo ditë në fletoren e detyrave, cilat janë këto detyra.

- > A ka në shkollë kujdestari për kryerjen e detyrave apo programe për tutorimin e nxënësve?
- > A ka njoftime nga mësuesja/mësuesi në fletoren e detyrave?
- > A duhet të reagoni?

Ju mund të bisedoni herë pas here me mësuesen kujdestare/mësuesin kujdestar, nëse fëmija i kryen tërësisht detyrat e shtëpisë.

Për problemet në komunikimin gjuhësor, mund të njoftoni mësuesin, me qëllim që shkolla të mund të kërkojë një mentor/e prindërisht e cila/i cili të përkthejë gjatë bisedës.



KONSULTIME TË MËTEJME

Punonjësja sociale e shkollës

Në shumë shkolla ka punonjëse/punonjës social. Fëmijët/të rinjtë, mësuesit dhe prindërit mund t'ju drejtohen këtyre, në raste problemesh (p. sh. ngacmime, vështirësi në mësim etj.).

Shërbimi dhe konsultimi psikologjik në shkollë

Konsultë dhe mbështetje për nxënësit, nxënëset, prindërit dhe mësuesit në çështjet që kanë të bëjnë me shkollën. Konsulta është falas, rreptësisht konfidenciale dhe e pavarur nga shkolla!

Nëse dëshironi takim, mund të drejtoheni pranë:

Schulpsychologische Beratungsstelle

Cäcilienstraße 56

74072 Heilbronn

Takimet vetëm me konfirmim:

Telefon: 07131 6437762

spbs@ssa-hn.kv.bwl.de



REDAKTION

Landratsamt Heilbronn
Heide Hindahl
Bildungskordinatorin für Neuzuwanderer
Migration und Integration
Lerchenstraße 40
74072 Heilbronn
Telefon: 07131 9948470
h.hindahl@landratsamt-heilbronn.de

WWW.LANDKREIS-HEILBRONN.DE

IMPRESSUM

Herausgeber: Landratsamt Heilbronn
Konzeption & Gestaltung: DIE NECKARPRINZEN
Kommunikation und Design GmbH, Heilbronn

Um die Informationen der Broschüre auf dem neuesten Stand zu halten, bitten wir, uns Änderungen bezüglich der dargestellten Inhalte und Ansprechpersonen mitzuteilen.

